



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2026/0363
Data e Vendimit: 08.06.2026

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 05/L-092, pas shqyrtimit të ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) N.T “Fer-Petroll” kundër vendimit lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me karburante” me numër të prokurimit:201/26300-26-2068-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) –Agjencia Qendrore e Prokurimit, Kryesuesi i Sekretariatit, me datën: 08.06.2026, mori këtë:

Vendim

I. Refuzohet si e jashtëafatshme, ankesa e OE N.T “Fer-Petroll” me nr. të protokollit 0363/2026, e datës 05.06.2026, e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me karburante” me numër të prokurimit:201/26300-26-2068-1-1-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit, në cilësi të AK-së.

II. I lejohet, autoritetit kontraktues- Agjencia Qendrore e Prokurimit, që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit si në pikën I të dispozitivit, përkitazi me këtë ankesë, nëse për të nuk ka ndonjë ankesë tjetër.

III. Operatori ekonomik me rastin e parashtrimit të ankesës nuk ka paguar fare tarifë andaj ankesa e OE ankues konsiderohet edhe si jo e plotë sipas nenit 111 par 1.10 dhe nenit 118 par 1 dhe 2 te LPP-se si dhe nenit 69 par 2 te Rregullores për Prokurim Publik.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale-

Autoriteti kontraktues (AK) – Agjencia Qendrore e Prokurimit me datën 17.04.2026 ka publikuar njoftimin për kontratë për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me karburante” me numër të prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1.

Sipas Formularit standard për korrigjimin e gabimeve të datës 20.05.2026 me datën 02.06.2026 është planifikuar hapja e ofertave.

Me datën 28.05.2026 në orën 16:50 që i bie me datën 29.05.2026, Operatori Ekonomik N.T “Fer-Petroll” ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK e cila është refuzuar me datën 29.05.2026 si e pabazuar.

Me datën 05.06.2026, Ankuesi (me të dhëna si më lartë) ka parashtruar ankesë në OSHP me numër protokolli 2026/0363.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Nga provat e prezantuara vërtetohet se për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me karburante” me numër të prokurimit: 201/26300-26-2068-1-1-1, Ankuesi ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK jashtë afatit ligjor.

Kërkesa për rishqyrtim është parashtruar me datën 28.05.2026 në orën 16:50 që i bie e parashtruar me datën 29.05.2026 është e jashtëafatshme sepse sipas formularit për korigjim të gabimeve të datës 20.05.2026 hapja e ofertave është planifikuar të bëhet me datën 02.06.2026, andaj kërkesa për rishqyrtim ka qenë dashur të parashtrohet me datën 27.05.2026 dhe si e tillë është në kundërshtim me nenin 60.1, pika a) të RRPP-së, jashtë afatit prej 5 ditësh para hapjes së ofertave.

OSHP sqaron se kundër çdo vendimi të marrë nga autoriteti kontraktues në përputhje me rrethanat e nenit 108/A çdo palë e interesuar mund të parashtrorë ankesë pranë OSHP-së, pas udhëheqjes së një procedure paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjes në përputhje me nenin 108/A të këtij ligji.

Sipas nenit 60 pika 1 të Rregullores për Prokurimin Publik, Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Andaj, Paneli Shqyrtues i vë në dijeni AK se në çdo aktivitet duhet të veprohet konform dispozitave dhe autorizimeve ligjore siç parashihen ato me nenet 1, 6, 7, 27, 28, 51, 59, 60, 69 të LPP.

Poashtu, Organi Shqyrtues i Prokurimit, sqaron se sipas nenit 111 paragrafi 1. 10 të Ligjit për Prokurim Publik çdo palë e interesuar mund të dorëzojë një ankesë në OSHP nëse ankesa e tillë ka dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit, të përmendur në nenin 118 të këtij ligji.

Sipas nenit 118 paragrafi 1 dhe 2 i LPP-së thuhet: “1. Ankuesit duhet të paguajnë një tarifë të ankesave në OSHP vlera e së cilës do të përcaktohet nga KRPP-ja në legjislacionin detyësor. Dëshmia e pagesës duhet të bashkëngjitet vetë ankesës në përputhje me nenin 111 të këtij ligji. Pagesa do të bëhet në para të gatshme ose në ekuivalent të parave të gatshme në një llogari të hapur nga OSHP-ja në përputhje me Rregullat Financiare. 2. OSHP nuk do të pranojë ankesën nëse tarifa nuk paguhet”.

Andaj, mbi bazën e të lartcekurave, OSHP konstaton se operatori ekonomik ka parashtruar ankesë jo të plotë siç parashihet me dispozitat e legjislacionit primar dhe sekondar dhe me Rregulloren e Punës së OSHP-së me saktësisht nenit 111 par 1.10 dhe nenit 118 par 1 dhe 2 te LPP-se si dhe nenit 69 par 2 te Rregullores për Prokurim Publik.

Sipas te lartcekurave, Autoritetit kontraktues mund të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit të cekur si më lartë përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Kryesuesi i Sekretariatit të OSHP-së, duke u bazuar në atë që u tha si më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Ardian Behra
Kryesues i Sekretariatit

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Agjencia Qendrore e Prokruimit**
- **OE - N.T. „Fer-Petroll**
- Arkivës së OSHP-së: